

FJALA E DEPUTETIT SALI BERISHA

E ENJTE 21 SHTATOR 2023

Pastor, meqenëse aludove ndaj meje, unë kam këtë përgjigje për ty: kujtohu pak, se riti i temjanit ka të bëjë me përzënien e djallit nga kisha, me përzënien e shpirtit të keq. Prandaj, mos e harro kurrë këtë dhe kije parasysh kur të dalësh këtu! Për Kuranin ka fjalë tjetër, e them edhe atë unë. Tani, këtu po diskutohet për fondet private të pensionit. Këto janë një ligjësi pothuajse në shumicën e vendeve. Por, në qoftë se sot ka njerëz më të mjerë në Europë, ata janë pensionistët shqiptarë, të cilët, sipas Eurostat-it, nga viti 2021 në vitin 2023 janë përballur me një rritje të indeksit të harmonizuar të çmimeve të konsumit, rreth 70-80% dhe janë jashtë mundësisë së ekzistencës së tyre. Sot skema e pensioneve ekzistuese fakton se 48% e pensionistëve, që janë në Shqipëri, janë me pension të pjesshëm. Do të më lejoni t'ju lexoj vetëm një të dhënë. Një pensioniste merr pension pleqërie të plotë 6 259 lekë të vjetër. A mund ta imagjinoni ju këtë? Gjithashtu, nga kompensimi i shpenzimeve për shkak të ndryshimit të çmimit të energjisë merr 200 lekë; nga kompensimi i të ardhurave mujore deri në masën 760 lekë, me VKM-në nr. 763 merr 398 lekë. Kjo zonja apo ky zotëria gjithsej në total merr 6 857 lekë, dhe asnjë prej jush nuk ngrihet këtu t'i japë përgjigje këtij problemi. Përgjigjja është vetëm një: vendosja e minimumit jetik për çdo shqiptar. Çdolloj mase që mund të merret në rrafshin financiar monetar absolutisht justifikohet 100% për të vendosur minimumin jetik. Ndaj, edhe këto që thonë ju janë hipokrizi, janë lot krokodili, janë pashpirtësi. Si t'ua zgjidhim hallin në këtyre? Si kjo zonja apo si ky zotëria, nuk po lexoj emra këtu, janë 48% e pensionistëve, ndërsa në rrimë e citojmë këtu pensionet e larta në fshat dhe pensionet e larta në qytet. Po për këta që janë me pension të pjesshëm, që janë 48% e pensionistëve?

Edhe ato të lartat nuk arrijnë kurrkund; ato të fshatit janë inekzistente. Edhe një herë, urdhëroni, ja ku i keni të dhënatsipas Eurostat-i, po jua tregoj këtu, indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit në vitin 2023 është 70-80% më i lartë se në vitin 2021, kjo është sipas Eurostat-i. Çfarë ka treguar Eurostat-i? Eurostat-i tregon se Shqipëria ka një inflacion të paktën 17,5% më të lartë seç e tregon INSTAT-i. Por juve nuk ju interesojnë dhimbjet e njerëzve; nuk ju interesojnë hallet e tyre; nuk ju interesojnë lotët e mjerimit të qindra mijëra shqiptarëve, që mezi sigurojnë kafshatën! Rritni rrogat. A e dini ju se vendimi që keni sjellë këtu për të rritur rrogën e gjykatësve 7 milionë lekë, do të thotë që gjykatësi do të marrë sa 117 qytetarë me pensionin që unë ju lexova këtu?! A nuk është kjo një pashpirtësi ekstreme? A e dini ju se shteti ka një detyrë në ndarjen e të ardhurave, ka një komponent social në zbutjen e tij? Meqenëse folët për atë, një ditë do të sjell këtu një studim të një prej institucioneve më prestigjioze, se ku renditej Shqipëria për shpërndarjen e të ardhurave. Pastaj nuk do të ndihesh mirë; jo, nuk do të ndihesh mirë! Unë ju them një gjë: nuk keni pse vendosni një hipotekë të tillë ndaj një njeriu, i cili është objekt i hetimit të rëndë, objekt i hetimit të thellë në SHBA. Për herë të parë në historinë e vendit Shqipëria përfaqësohet nga një delinkuent. Po, po, këtë nuk po e them unë, e thotë Gjykata Amerikane, e thotë Kongresi Amerikan. Nuk ka turp më të madh se ky! Përsëri, SPAK-u i partisë nuk hap hetim. A ka dëshmi më flagrante sesa nënshtrimi i plotë ndaj Edi Ramës, që të mos hapësh hetim? Po hap hetim Kongresi i SHBA-ve, pa le më prokuroria dhe gjykata! Këtu ai ka kryer veprimtari kriminale. Edi Rama, McGonigal, Dorian Duçka, Agron Neza kanë funksionuar si grup i strukturuar kriminal; kanë kryer veprime kriminale kundër opozitës, kanë kryer veprime kundër biznesit, gjobëvënie dhjetëramilionëshe, gjithashtu janë marrë me licenca dhe sot po gjobisin shtetin. Po për pastorin, Amant Josifi, çfarë na thua? A ndjen ti dhembshuri dhe përdëllim për 2,4 miliardë euro të pensionistëve europianë, që janë vjedhur prej skemës së tij? Këtu nuk lëviz asgjë, se ishte i vëllai i Kryeministrit dhe Olta Xhaçka në skemë. Mos harro! Interesat partiake janë interesa partiake, por njerëzia është e para. Po të garantoj se, sado që të sulmosh Sali Berishën, nuk të bëjnë kryetar të grupit parlamentar, se nuk kanë besim përfundimtar tek ti, janë ateistë. Kaq kisha